



AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE (AKBN)



BILANCI KOMBETAR ENERGETIK 2010

Tirane 2011

BILANCIN ENERGETIK 2010

Shqipëria po punon për një sektor energjie të besueshëm dhe të qëndrueshëm, zhvillim i të cilit bazohet në shfrytëzimin e të gjitha opsioneve të energjisë në mënyrë që të plotësojmë nevojat tona për energji dhe për të krijuar vlerë të shtuar për qytetarët e Shqipërisë, në përputhje me parimet e përgjegjësishë mjedisore, ekonomike dhe sociale.

Në mënyrë që të arrihet një zhvillim i vazhdueshëm i një sistemi të energjisë, nevojiten investime në kohë dhe efikase. Në këtë kuptim, strategjia e Qeveria së Shqipërisë luan një rol kyç në krijimin e një ambienti stimulues për investime në strukturën e energjisë, veçanërisht për kapacitetet e reja të prodhimit dhe në uljen e rrezikut për investitorët me anë të aktiviteteve të saja dhe kuadrit transparent, të qartë dhe të qëndrueshëm të politikave strategjike.

Problemet me të rëndësishme me të cilat do të përballëtohen në të ardhmen zhvillimi ekonomik i vendit dhe sektori energjetik në veçanti, janë rritja e konsumit të energjisë për banorë dhe mbajtja në të njëjtën kohë e një niveli relativisht me të ulët të intensitetit të energjisë, të cilat kërkojnë nxitjen e një ekonomie eficientë dhe konkurruese. Intensiteti i energjisë në Shqipëri konsiderohet i lartë krahasuar me vendet e rajonit. Për rrjedhojë, sektori i energjisë në Shqipëri do të vazhdojë të përballëtohet me dy sfida të rëndësishme: (i) mbajtjen e këtij intensiteti në nivele mesatare, dhe (ii) rritjen e konsumit të energjisë për banorë (ritjen e komoditetit të jetesës).

Ketij qëllimi i shërben paraqitja e bilancit energjetik të vitit 2010 i cili paraqet në mënyrë të sintetizuar, furnizimin e vendit tone me burime energjetike, të cilat janë të domosdoshme për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë së vendit. Gjithashtu ai paraqet lëndët energjetike në transformimin e tyre, duke nxjerrë në mënyrë indirekte problematiken dhe teknologjite që shërbejnë në perpunimin e tyre, me qëllim efikasitetin e përdorimit të energjisë. Pjesa e konsumit të bilancit ka vlerë , pasi tregon se cilat lëndë energjetike dominojnë tregun, si shpendahen ato, cilat janë problemet e konsumit dhe si duhet të merren masat në përmirësimin e tij.

Domosdoshmeria e Bilancit Energjetik lidhet edhe me problemet dhe sfidat e mprehta energjetike me të cilat ballafaqohet vendi ynë. Shqipëria vazhdon të paraqitet një vend me një konsum energjie për banorë shumë të ulët dhe me një intensitet të lartë energjie si rezultat i teknologjive të vjetra që përdoren në shumë dege të ekonomisë si dhe paisjeve me standarte jo bashkohore që përdoren në sektorin e banesave dhe të shërbimeve. Problemet e alternativave të furnizimit me burime energjetike kanë ndikuar në nivelet e ulëta të aktivitetit ekonomik si dhe në nivele modeste të komfortit të jetesës.

Ky dokument përfaqëson një pasqyrë informacioni të gjithë hapsirës së zhvillimit të sektorit energjetik, duke filluar nga kërkesa, rezervat, opsionet e furnizimit deri edhe tek sjellja e konsumatoreve. Synimi thelbësor i bilancit është paraqitja e informacionit të sektorit energjetik duke dhënë garantimin e një furnizimi të sigurt me energji për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

1. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE

Shqipëria, është një prej pak vendeve të cilat kanë patur një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme prej mbi 6 përqind për gati një dekadë, është duke kaluar një “momentum” pozitiv ekonomik. Kjo konfirmohet me se tepërmi me performancën e ekonomisë gjatë dy viteve të fundit, ku me gjithë problemet në energjinë elektrike, thërrasjen në bujqësi e se fundmi krizën financiare e rënien ekonomike në tregjet e huaja, rritja ekonomike e vendit tona vazhdon të jetë në nivele të larta.

Krahas progresit teknologjik e reformimit strukturor të ekonomisë, implementimi gjatë këtij trevjeçari i një sere politikash e reformash efikase makroekonomike, të orientuara qartë nga “filozofia” e stimulimit të rritjes ekonomike nëpërmjet nxitjes së ofertës agregate, i kanë dhënë një shtytje mjaft të fortë ekonomisë. Ndjekja e politikave makroekonomike të mirë - planifikuara e mirë - koordinuara dhe thellimi i mëtejshëm i reformave ekonomiko – strukturorë, krahas proceseve të tjera të natyrishtme në të cilat po kalon ekonomia si, progresi teknologjik, akumulimi i kapitalit e ristrukturimi i ekonomisë drejt një ekonomie gjithnjë e më efikase, do të sigurojnë që kjo ecuri ekonomike të vazhdojë e të lartë edhe të pakten në për një të ardhme afatmesme. Duke marrë në konsideratë situatën e pafavorshme në ambientin e jashtëm, e cila pritet të vazhdojë të pakten edhe për një periudhë afatshkurter, norma e parashikuar e rritjes reale ekonomike për vitet 2009 – 2012 vlerësohet të jetë mesatarisht në nivelin e 3-4 përqind.

Situata jo e mirë ekonomike që pritet për një numër të konsiderueshëm të ekonomive me të mëdha botërore, sigurisht që përben një risk potencial edhe për ecurinë ekonomike të vendit tonë. Megjithatë, këtu duhet theksuar që pika e fortë apo promotori kryesor i zhvillimit ekonomik të Shqipërisë qëndron në tregun dhe në aktorët ekonomik të brendshëm të këtij vendi, gjë e cila e vendos ekonominë shqiptare në një pozicion relativisht të mbrojtur ndaj zhvillimeve ndërkombëtare jo të favorshme.

Gjithashtu autoritetet përgjegjëse për hartimin dhe ndërmarrjen e politikave makroekonomike janë plotësisht të fokusuar në zhvillimet e mëtejshme dhe janë plotësisht të angazhura që nëpërmjet këtyre politikave të injektojnë stimuj shtesë në ekonomi në kohën dhe në masën optimale, me qëllim lehtësimin sa më tepër të efekteve negative që mund të vijnë nga zhvillimet e tregjeve të huaja. Deri më tani politika monetare e planifikuar, krahas një mbikqyrjeje me të afertë të sistemit bankar, duket të jetë mbajtja në këto nivele të normës bazë së interesit me qëllim ruajtjen e stabilitetit të çmimeve e të ekuilibrave në sistemin financiar. Megjithatë në rast të një kontraktimi të ekonomisë, investimeve e konsumit, e në rast të një rënie shqetësuese të nivelit të përgjithshëm të çmimeve, duhet theksuar që politika monetare shihet si një instrument tepër i gatshëm e më mjaft hapësirë manovrimi, si dhe mjaft efektiv për të amortizuar këto efekte negative e për t’i dhënë impulse nxitëse ekonomisë. Në të njëjtën kohë edhe politika fiskale e parashikuar për vitin 2009 duket mjaft adekuate për këto situata ekonomike. Për vitin në vijim është parashikuar që të realizohet një nivel i lartë investimesh publike, kryesisht në infrastrukturën rrugore, por jo vetëm. Këto investime shihen si tepër efikase e efikente si në perspektivën afatshkurtes ashtu dhe në atë afatgjatë të ekonomisë. Në afatin e shkurtër këto

investime do te ndihmojne te mbajne ne nivele te larta kerkesen agregate, e rrjedhimisht prodhimin, punesimin te ardhurat e konsumsumin ne ekonomi, ku risku per nje kontraktim te mundshem te tyre perben dhe shqetesimin kryesor afatshkurter. Nga ana tjetere duke qene se investimet ne infrastrukture ne vendin tone kane nje kthyesmeri mjaft te larte, kjo politike fiskale e prirur drejt investimeve ne infrastrukture shihet mjaft eficiente edhe ne kendveshtrimin afatgjate te ekonomise. Gjithashtu, sa i perket efikasitetit te politikes fiskale per te nxitur ekonomine ne afatin e shkurter, nje tjetere aspekt mjaft pozitiv i kesaj politike eshte financimi me kapitale te huaja i nje pjese te konsiderueshme te investimeve te planifikuara, duke i lene keshtu te gjitha hapesiren e nevojshme biznesit vendas qe te vazhdoje te kreditohet nepermejt kapitalit vendas e te vazhdoje normalisht aktivitetin e tij ekonomik. Ne buxhetin e vitit 2010 eshte parashikuar edhe nje sasi e konsiderueshme kontigjencash, te cilat do te jene te disponueshme per t'u alokuar ne drejtime te ndryshme te ekonomise ne rast se efektet negative te krizes ekonomike do te jene me te forta se sa jane parashikuar.

Vihet re se ne tremujorin e tretë të vitit 2010, ekonomia shqiptare vlerësohet të jetë rritur me rreth 4.9% në terma realë. Ky ritëm rritjeje është i ngjashëm me të njëjtin tremujor të një viti më parë (4.4%), por qëndron 1.6 pikë përqindje më lart krahasuar me tremujorin paraardhës. Sektori i industrisë ka shënuar normën më të lartë të rritjes gjatë të tre tremujorëve të vitit 2010, i nxitur nga një kërkesë e lartë për lëndë të parë. Industria u rrit me 18.2% në terma vjetorë dhe 1.8% në terma tremujorë. Ritmi i rritjes së sektorit të shërbimeve i është rikthyer prirjes së një viti më parë duke shënuar vlerën 8.3% në terma vjetorë krahasuar me 1.5% në fillim të vitit. Brenda sektorit të shërbimeve, transporti ka qenë kontribuesi kryesor i rritjes, ndërkohë që posta/telekomunikacioni vijon tkurrjen e nisur që nga fillimi i vitit 2010. Sektori i ndërtimit, gjatë tremujorit të tretë 2010, u tkurr me 22% në terma vjetorë me një përkeqësim të mëtejshëm në terma tremujorë prej -2.5%. Tkurrja e vazhdueshme e sektorit të ndërtimit që prej tremujorit të fundit të vitit 2009, është një reflektim i uljes së investimeve nga familjet dhe bizneset në pasuri të paluajtshme, shoqëruar me frenimin e kreditimit për këtë qëllim nga sektori bankar.

Treguesit e ekonomisë reale konfirmojnë se gjatë të vitit 2010, ritmet e rritjes së ekonomisë shqiptare janë përmirësuar. Për çdo muaj gjatë periudhës, normat vjetore të inflacionit janë luhatur rreth normës së synuar nga Banka e Shqipërisë (3%), shoqëruar nga një qëndrueshmëri e kursit të këmbimit, një korrigjim i ndjeshëm i deficitit tregtar dhe i llogarisë korente. Konsumi privat është zhvilluar me ritme më të ngadalta, si rezultat i rritjes së normës së papunësisë krahasuar me një vit më parë, si edhe për shkak të një rritjeje më të moderuar të pagës mesatare dhe të dërgesave të emigrantëve. Politika fiskale ka qenë më e shtrënguar duke u reflektuar në uljen e deficitit fiskal.

Rritja e depozitave ka përmirësuar likuiditetin në sektorin bankar duke ofruar mbështetje më të mirë për investimet private. Pavarësisht se sektorët e industrisë dhe të shërbimeve deklarojnë një rritje të shfrytëzimit të kapaciteteve afër vlerave të mesatares afatgjatë, prishmëritë për rritjen e investimeve në të ardhmen mbeten të pasigurta. Gjithashtu, niveli mesatar i kreditimit të

ekonomisë gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2010 ka qenë me ritme të moderuara megjithë përmirësimin e shënuar në dy muajt e fundit të vitit. Kostoja e financimit mbetet një element që mund të përdoret më mirë nga bankat, për të stimuluar rritjen e aktivitetit kreditues.

Politika fiskale ka vijuar të kontribuojë pozitivisht në kërkesën agregate, ndonëse në vlera më të ulëta se një vit më parë. Krahasuar me të dhënat e vitit 2009, gjatë vitit 2010 të ardhurat e përgjithshme kanë shënuar një rritje prej 8.4%, ndërkohë që shpenzimet e përgjithshme kanë rënë me 4.5%. Realizimi i planit është arritur në masën 97.3% të nivelit të planifikimit vjetor për të ardhurat, dhe në masën 97.6% për shpenzimet e përgjithshme. Në totalin e shpenzimeve, ndryshimet kanë ardhur për shkak të rënies së konsiderueshme të shpenzimeve kapitale, në masën 29.6% në krahasim me fundin e vitit paraardhës, ndërsa shpenzimet korente kanë shënuar një rritje prej 6%. Ecuria e të ardhurave dhe shpenzimeve të përgjithshme në buxhetin e shtetit gjatë vitit 2010 ka sjellë ndryshime të dukshme në deficitin fiskal vjetor, i cili shënoi një nivel prej rreth 38 miliardë lekësh, rreth 53% më i ulët krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2009.

Sipas sektorëve, vërehet se treguesi i besimit të sektorit të ndërtimit është përmirësuar me 9.4 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, si rezultat i rritjes së kërkesës dhe prodhimit të tij, duke u reflektuar në rritjen e punësimit. Zhvillimet në sektorin e industrisë janë karakterizuar kryesisht nga përmirësimi i kërkesës për produktet e tij, ndërkohë që sektori i shërbimeve ka shfaqur një përmirësim të gjendjes financiare gjatë tremujorit të katërt të 2010. Shfrytëzimi i kapaciteteve është rritur në të gjithë sektorët por vijon të mbetet poshtë mesatares afatgjatë, sidomos për sektorin e ndërtimit.

Pritshmëritë në lidhje me zhvillimet ekonomike për tremujorin e parë 2011 janë pozitive për sektorin e industrisë, ku pritet një rritje e kërkesës dhe prodhimit. Sektori i shërbimeve vlerëson se ecuria e biznesit do të jetë në rënie gjatë fillimit të vitit 2011 për shkak të uljes së kërkesës. Përmirësimi i ecurisë së sektorit të ndërtimeve gjatë vitit 2010, është reflektuar dhe në pritshmëritë e tij pozitive për fillimin e vitit 2011. Kështu, sektori i ndërtimit pret një rritje të kërkesës dhe të prodhimit gjatë fillimit të vitit që është reflektuar në pritshmëri pozitive për rritjen e punësimit.

Gjatë vitit 2010, paga mesatare mujore u rrit me një normë vjetore nominale prej 5.25% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në terma realë, norma e rritjes ishte 1.75%, rreth 7.5 pikë përqindje më e ulët se një vit më parë. Pavarësisht rënies së aktivitetit ekonomik, sektori i ndërtimit ka vijuar të rrisë pagën mesatare mujore me rreth 14.5% në terma nominalë vjetorë, ndërkohë që paga mesatare mujore në sektorin e industrisë është rritur me 8.5% dhe është zvogëluar me 2% në sektorin e shërbimeve. Ritmi i rritjes nominale vjetore të pagës mujore në sektorin shtetëror është ngadalësuar në 6.4% krahasuar me 16.4% të një viti më parë.

Për sa i përket të ardhurave nga dërgesat e emigrantëve, gjate tremujorit te fundit te vitit 2010 ato rezultuan 135 milionë euro, me një rritje të lehtë prej 3% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Parashikimet⁴⁴ për përqëndrimin e normës së papunësisë në Greqi gjatë vitit 2011

dhe qëndrimi në vlera të përafërta për Italinë, sugjerojnë se rigjallërimi i dërgesave të emigrantëve nuk do të jetë i shpejtë dhe i ndjeshëm.

Tabela 1. Treguesit Kryesore Makroekonomike

	Njesia	Njesia	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
GDP (me cmimin aktual)	€	billion €	4.6	4.7	5	5.9	6.6	7.2	7.8	8.9	8.7	8.9
Popullsia	banore	milion	3.06	3.08	3.1	3.12	3.13	3.15	3.16	3.17	3.19	3.19
GDP / banor*	€/ head	€	1489.1	1531	1623	1884	2090	2300	2,470.5	2,800.8	2,746.5	2,782.8
GDP / banor*		USD-PPP	3946.9	4185	4636	4988	5387	5864	7,116.9	7,996.3	8,405.2	8,917.0
Ritja vjetore e GDP per Banor	%	%	7.9	4.2	5.8	5.7	5.8	5.5	6.3	7.2	4.8	3.8
inflacioni (CPI)	%	%	3.1	5.2	2.4	2.9	2.4	2.4	3.8	3.5	2.7	2.5
Kursi i kembimit (Mesatar)		Lek / US\$	143.5	140.2	121.9	102.8	99.9	98.1	90.4	83.9	96.5	103.9
Kursi i kembimit (Mesatar)		Lek / €	127.9	131.9	137.8	127.8	124.3	123	124	123	131.6	137.8

2. INTENSITETI ENERGJETIK DHE KONSUMI I ENERGJISE PER BANORE

Shqipëria paraqitet me një konsum energjie shumë të ulët për banorë. Në një shkallë të madhe kjo zbulon nivelet e ulta të aktivitetit ekonomik si dhe nivelet modeste të komfortit që krijohen në sektorin e popullatës dhe në ato të shërbimeve. Kështu, një nga çështjet më të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë shqiptare dhe sektorit të saj të energjisë është, se si mund të barazohet presioni i vazhdueshëm për të rritur konsumin e energjisë për banorë me nevojën, si dhe padyshim të njejtë, për të reduktuar intensitetin e lartë të energjisë, për të pasur një ekonomi eficiente e cila me tej të konkurojë si në tregun e brendshëm me mallrat e importit ashtu edhe në tregun e jashtëm, për të bërë të mundur ekzistencën e tregjeve të eksportit për kategori të caktuara mallrash dhe produktesh.


Konsumi energjetik për banorë është një tregues tjetër që shpreh mirëqenien, mënyrën e jetesës por nga ana tjetër dhe sjelljen apo qëndrimin e konsumatorëve përkundrejt konsumit të burimeve energjetike.

Treguesi i konsumit të energjisë për frymë të popullsisë për vitin 2010 rezultoi 0.589 toe/banor, ndërsa për vitin 2009 rezultoi në nivelin e 0.560 toe/banorë. Për vitin 2008 konsumi energjetik për banorë është vlerësuar në vlerën e 0.574 toe/ banorë.

Intensiteti energjetik është një tregues sintetik shumë i rëndësishëm, që tregon nivelin e zhvillimit të sektorit energjetik, sidomos në drejtim të eficiencës së energjisë. Ai shpreh raportin e konsumit të burimeve primare energjetike në një vit të caktuar me PBB-në të prodhuar po në atë vit. Historikisht, intensiteti i energjisë në Shqipëri ka qenë shumë i lartë. Kjo do të thotë, se prodhimi makro ekonomik, i raportuar normalisht nga PBB-ja ka qenë i ulët, krahasuar me konsumin e përgjithshëm të energjisë. Arsyet janë të njëjta si dhe për vendet e tjera të Europës Qendrore dhe

Lindore: industria shqiptare ka qene e orientuar drejt industrive intensive me konsum te larte te energjise si minierat dhe metalurgjia, ku cmimet e ulta te energjise kane mbizoteruar gjate gjithë kohes.

Intensiteti energjetik per vitin 2010 rezulton te jete ne nivelin 0.254 toe/000Euro. Ky intensitet rezulton me nje permiresim te tij qe e ka bazen ne konsumin e burimeve energjetike perkundrejt nje PBB-je me te larte se ajo e vitit 2009. (PBB-ja ka qene 8.9 miliard Euro ne vitin 2010). Intensiteti energjetik per vitin 2009 ka qene ne nivelin e 0.256 toe/000Euro. Zvogelimi i Intesitetit Energjetik lidhet me perdorimin efektiv te energjise ne shkalle vendi.



Grafiku 1: Intensiteti Energjetik dhe Konsumi / banore. Vitet 2007-2010

3. NDERTIMI I BILANCIT DHE SIGURIMI I INFORMACIONEVE

Bilanci i vitit 2010 eshte ndertuar ne metodiken e vleresimit si nga lart-poshte dhe nga poshte larte per te duke patur nje vlere mosperputhje 9% qe do te thote nje shfer te pranueshme per vendet ne zhvillim si eshte Shqiperia. Bilancet ndjek nje ecuri si te viteve 2000-2008 kjo bazuar ne eksperiencat dhe rekomandimet e institucioneve nderkombetare me te cilat eshte bashkepunar deri ne vitin 2008.

Analiza e verifikimit kryhet per te gjetur shifrat sa me te sakta te konsumit final te energjise dhe pse raportimet per furnizimin me lende energjetike, kryesisht produkte naftë dhe dru zjarri nuk i pergjigjen konsumit real te konsumatoreve. Kjo diference ndodh, per drute e zjarrit nga mungesa e statistikave te organeve pergjegjese qe e menaxhojne kete lendeve energjetike, ndersa produktet e naftes kryesisht karburante nga lëvizja e lire kufitare dhe informaliteti.

Theksojmë se metodologjia kontrollit të bilancit nga poshtë-lart përdoret jo vetëm në vendet e rajonit të naftës por edhe në vendet e zhvilluara për të kontrolluar sasitë e flukseve të lëvizjes së produkteve të naftës. Kjo metodologji llogaritje është mjaft e rëndësishme për vendin të naftës duke patur në konsideratë hapjen e kufijve dhe mundësinë e futjes të lendeve hidrokarbureve (karburante për automjete) nga vendet fqinje si pasoje e rritjes së fluksit të automjeteve që hyjnë dhe dalin në pikat kufitare.

Hartimi i Bilancit Energjetik, është mbështetur në të dhënat e mbledhura nga institucionet shtetërore dhe kompanitë e ndryshme, të cilat operojnë në fushën e energjisë në Shqipëri. Institucionet dhe informacionet e siguruar nga to, janë si më poshtë :

Informacionet mbi të dhënat makroekonomike dhe popullsinë janë siguruar nga :
Këshilli i Ministrave ; Ministria e Financave

Të dhënat mbi energjinë elektrike janë siguruar nga:

Enti Rregullator i Energjisë (ERE)

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a)

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a)

Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a)

Të dhënat për hidrokarburet janë siguruar nga:

Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës (METE)

Raporti vjetor i shoqërisë Albpetrol sh.a Viti 2009;

Raporti vjetor i shoqërisë ARMO sh.a Viti 2010;

Drejtoria e Përgjithëshme e Doganave;

Të dhënat për drutë e zjarrit, janë siguruar nga:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;

Investigimi nga AKBN-ja

Të dhënat për sektorin e transportit, janë siguruar nga:

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

Investigimi nga AKBN-ja

Të dhënat për sektorin e bujqësisë, janë siguruar nga:

Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe e Mbrotjes se Konsumatorit

Investigimi nga AKBN-ja

Te dhenat per sektorin e industrise, jane siguruar nga:

Qendra e Kombetare e Regjistrimit

4. FORMATI I BILANCIT ENERGETIK

Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 202, date 11.04.2007, “Per disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 547, date 9.8.2006, “Per krijimin e Agjencise Kombetare te Burimeve Natyrore”, Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore, ka detyrim te pergatise Bilancin Energjetik ne perputhje me formatin EUROSTAT/IAE.

Nga Instituti i Statistikave i Shqiperise (INSTAT), Ministrite, Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH), Operatori i Sistemit te Shperndarjes (OSSH), Enti Rregullator i Energjise (ERE) etj, sigurohen te dhena ne lidhje me ekonomine e Shqiperise, te dhena makroekonomike, cmimet, konsumi i elektricitetit, te dhena mbi popullsine, ndertesat, etj.

Vlen per t’u shenuar fakti, se ka te dhena mbi Sektorin e Banesave, ne lidhje me ndertesat bazuar ne kategorite e ndryshme te tyre, si dhe disa te dhena te dobishme mbi sektorin e ndertimit publik

Gjithashtu ka te dhenat per sektorin e transportit, lidhur me numrin e automjeteve, kamioneve, autobuzeve dhe furgonave dhe te dhenat te tjera. Bazuar ne REPOBA, te publikuar nga INSTAT, jane siguruar te dhena mbi numrin e banesave, mesataren e personave per banese, te ardhurat e tyre, punesimin ne sektoret publik dhe privat, bizneset ne te gjithe vendin (ndermarrjet), etj.

Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore dhe Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes (METE) kane se bashku detyren e mbledhjes dhe perpunimit te te dhenave, formulimit te pasqyrave dhe treguesve te energjise, analizimit dhe shperndarjes se informacionit.

Per hartimin e Bilancit Energjetik , te dhenat e mbledhura perpunohen dhe analizohen , duke i pershtatur me kerkesat e formatit te Eurostatit per Bilancin Energjetik.

Duhet theksuar se Bilanci i Energjise percaktohet ne perputhje me metodologjine EUROSTAT, vetem ne pasqyren agregate dhe jo ashtu si ajo duhet te jete, ne detaje,kjo per arsye se per te dhenat e konsumit te energjise ne deget e ndryshme te energjise, eshte ende e nevojshme te nxirren te dhena me te detajuara .

Veshtiresi ndeshen edhe ne procesin e vleresimit te humbjeve pergjate proceseve te transformimit nga burimet primare te energjise ne burime sekondare, sic jane produktet e naftes, energjia e marre nga djegia e qymyreve per qellime energjetike, energjia elektrike e perftuar nga TEC-et.

Ashtu sic eshte permendur edhe me lart, ende nuk ka te dhena te detajuara dhe te mjaftueshme per sa i perket kerkeses; si rrjedhim eshte e nevojshme te permiresohen statistikat mbi energjine, si per anen e furnizimit, ashtu edhe per ate te kerkeses, kjo edhe ne kuader te Komunitetit te Energjise, ku Shqiperia dhe te gjitha vendet e rajonit brenda vitit 2015 do te kene per detyrim te hartojne bilancet energjetike plotesisht sipas kerkesave te EUROSTAT-it .Prandaj kerkohet, qe Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore te mbeshtet me nje kuader me te plote ligjor , per te mundesuar sigurimin e te gjitha te dhenave me te nevojshme, te kerkuara prej saj.

5. STRUKTURA E BURIMEVE ENERGETIKE NE BILANCIN ENERGETIK

5.1 Burimet dhe konsumi energjetik

Per t'i paraprire rritjes se kerkeses per konsum te lendeve energjetike jane zhvilluar mjaft projekte ne fushen e energjise, si per rritjen e prodhimit te burimeve primare ne vend ashtu dhe per krijimin e nje infrastrukture energjetike interkonjeksioni ne menyre qe vendi yne te integrohet ne rrjetat Europiane te energjise per te marre pjese ne tregun kompetitiv te energjise elektrike dhe gazit natyror.

Burimet energjetike qe dominojne dhe kane mbajtur peshen kryesore ne Bilancin Energjetik jane: nafta dhe nen produktet e saj, hidroenergjia, drute e zjarrit, qymyri, gazi natyror dhe pak produkte dytesore te cilat vijne si rrjedhoje e shfrytezimit te energjise diellore dhe nxehtesise se perftuar nga proceset termike.

Tabela 2 Burimet Energjetike

Burimet Energjetike	%	ktoe
Qymyri	2.77%	58.19
Gazi	0.61%	12.84
Nafta dhe produktet	58.71%	1232.90
Drute e zjarrit	9.76%	205.00
En.djellore	0.32%	6.70
Hydro	27.82%	584.31

Per vitin 2010, Totali i Produkteve Primare Energjetike (TPPE) ka rezultuar ne 2105,55 Ktoe, me nje rritje 40 ktoe krahasuar me vitin 2009. Në furnizimin sipas burimeve, për vitin 2010 vlen të përmendet që hidrokarburet kanë kontribuar me 1232.9 ktoe, ose 58.7% përkundrejt totalit,

energjia elektrike me 584.3 ktoe, ose 27.9%, drutë e zjarrit me 205 ktoe, ose 9.7%, dhe pjesa tjetër përbëhet nga burime të tilla si qymyri, gazi natyror dhe energjia e përftuar nga panelet diellore.

Pavarësisht se situata e furnizimit me produkte primare energjetike vjen gjithmonë në rritje, tregu i vendit tonë ka mbetur kërkon përmirësime në sigurinë e furnizimit me energji. Produktet primare energjetike kanë mbajtur këto peshe përkundëjt totalit të burimeve të paraqitura në figurën 2.




Figura.2: Burimeve Primare Energjetike per vitin 2010. [%]

Vlen të përmendet që për vitin 2010 prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet ka një maksimum krahasuar me vitet e tjera duke aritur vlerën 584.31 ktoe. Importet për vitin 2010 kapin vlerën 62 %, ku kontributin kryesor e kanë lëndet energjetike me baze hidrokarbure, ndërsa eksportet kapin vlerën 36 %. Me poshtë është paraqitur ecuria në vite e Totalit të Produkteve Primare Energjetike (2005-2010) e shprehur në ktoe.




Figura 3: Ecuria në vite e burimeve energjetike [ktoe]

5.2. Veteplothesimi i nevojave me burime energjetike

Ne krahasim me vitin 2010, vihet re nje ulje e lehte e veteplothesimit te nevojave me burime energjetike. Nga 43.3% ne vitin 2009 krahasuar me 37.9% ne vitin 2010, e cila ka ardhur si rrjedhoje e rritjes se eksportit te naftes brut, nga 362 ktoe per vitin 2009 ne 501 ktoe per vitin 2010. Ne prodhimin vendas te hidrokarbureve ka nje rritje nga 576.6 Ktoe ne vitin 2009 ne 743.9 ktoe ne vitin 2010.




Figura 4: Veteplothesimi me burime energjetike 2010 [%]

6. ANALIZA E SIGURIMIT TE BURIMEVE ENERJETIKE

6.1 Furnizimi me nafte dhe nenproduktet e naftes

Furnizimi i ekonomise me nafte, gaz dhe nenprodukte eshte bere nga importi dhe prodhimi vendas. Vlen te theksojme qe per vitin 2010 prodhimi vendas i naftes brut arriti kuoten me te larte keto 10 vjetet e fundit, ndersa perpunimi i produkteve te naftes dhe gazit arriti kuoten me te ulet 157.47 ktoe.

Niveli i prodhimit te pergjithshem te naftes bruto ne vend (Albpetrol, Bankers Petroleum Albania Ltd dhe Steam Oil & Gas) per vitin 2009 ishte 743.945 ktoe dhe ne vitin 2009 ishte 576.626 ktoe. Duhet te theksohet se, per nje perdorim me te mire te rezervave tona ne vendburimet naftembajtese ekzistuese duke rritur koeficientin e nxjerrjes se naftes permes perdorimit te teknologjive te ndryshme te reja dhe zbulimit te rezerva te reja, jane nenshkruar dhe jane miratuar marreveshje hidrokarbure me disa kompani te huaja, te tilla si Bankers Petroleum

Albania Ltd dhe Oil & Gas Steam per vendburimet ekzistuese te naftes dhe te gazit dhe Island International Exploration BV, MedOil dhe DWM Petroleum AG ne blloqet e reja te kerkimit.

Sektori i rafinerise eshte privatizuar ne 85% te aksioneve qe nga viti 2008. Si rezultat i nje programi ambicioz te investimeve nga kompania Albania Refinery Marketing Oil (ARMO Sh.a.) do te permiresohen teknologjite e perpunimit dhe prodhimit te nenprodukteve te naftes si ne aspektin e permiresimit te paisjeve ekzistuese, te cilat jane amortizuar ashtu edhe rinovimin me nje teknologji moderne te re. Ne perputhje me programin e investimeve te percaktuar ne kontraten e shitjes, ARMO sh.a ka permiresuar ndjeshem produktet dhe vecanerisht benzinen dhe gazoilin duke kaluar nga prodhimi i gazoilit sipas standardit SSH: 31:1997 ne gazoil sipas standard SSH EN 590, sic eshte percaktuar me Vendimin Nr. 147, date 21.03.2007, dhe benzinen me standardin SH EN 228.

Bazuar ne treguesit e bilancit te vitit 2010, furnizimi i ekonomise sone me nenprodukte nafte dhe gazi natyror realizohet nga dy aktivitete; nepermjet prodhimit vendas dhe importit. Megjithese, prodhimi vendas i nenprodukteve te naftes dhe gazit ploteson rreth 13% te nevojave te ekonomise, ai luan rol te rendesishem ne tregun e vendit per vendosjen e ekuilibrave te drejte ne furnizimin e sektoreve, si dhe per te mbajtur nen kontroll luhatjet e cmimeve.

Shperndarja gjeografike e instalimeve, depozitave dhe stacioneve te shitjes me shumice dhe pakice mbulojne te gjithe territorin e Shqiperise, duke garantuar nje furnizim normal te konsumatoreve ne te gjithe vendin.

Rezervat e sigurise jane rritur vazhdimisht nga viti ne vit, nga 13442 ton ne vitin 2001 ne 105670 ton ne vitin 2009. Megjithate, per sa i perket aspekteve ligjore dhe administrative qe kane te bejne ne kete rezerve, ne vitin 2010, eshte parashikuar te kete nje studim me qellim permiresimin e procedurave, duke marre parasysh praktikat me te mira te vendeve te Bashkimit Evropian, referuar edhe direktives se BE.

Per vitin 2010 nxjerrja e naftes vetem nga Albpetroli u realizua 134 227 ton.

Gjate ketij viti operatori Bankers ka realizuar nje prodhim 571 286 ton ne vit.

Importi i produkteve te naftes dhe i naftes bruto per vitin 2010 arrin vleren 1080.43 ktoe duke patur nje rritje me 30 ktoe krahasuar me vitin 2009. Kjo rritje ka ardhur si pasoje e rritjes te parkut te automjeteve. Eksporti i naftes dhe i produkteve te saj per vitin 2010 arriti 501.5 ktoe duke pesuar nje rritje 28 % ktoe krahasuar me vitin 2009. Rritja ne vitin 2010 ka ardhur si pasoje e shtimit te sasise se eksportit te naftes brut nga kompania Bankers dhe sasite e larta te produkteve te eksportuara nga kompania ARMO te tilla si benzin verxhine, koks, solar dhe bitum.




Figura 5. Ecuria e prodhimit te naftes dhe importit te produkteve te saj ktoc (1929-2010)

Nxjerrja e gazit per vitin 2010 ka qene rreth 12.8 ktoc, sasi gati e papërfillshme dhe që shërben vetëm për furnizimin e rafinerive dhe proceseve teknologjike të industrisë së naftës. Pavarësisht nga studimet e shumta vendi ynë nuk është lidhur me rrjetin ndërkombëtar të gazit. Është e kuptueshme se lidhja e Shqipërisë me rrjetin e gazit do të ketë një ndikim pozitiv në përmirësimin e situatës energjetike në vend duke ndikuar në mënyrë të ndjeshme në raportet e përdorimit të energjive ku deri më sot ngarkesa kryesore i takon produkteve të naftës dhe energjisë elektrike.

Gazi i lenget i naftes (GLN) ne vendin tone, ka rritur ne menyre te ndjeshme prezencen dhe po luan nje rol gjithmone e me te madh ne tregun vendas, si burimi energjetik alternativ me i mundshem per te zevendesuar energjine elektrike ne sektorin e banesave dhe sherbimeve duke u konsumuar kryesisht per ngrohje dhe gatim, Konsumi i tij ne total per vitin 2010 ka arritur ne 105 ktoc. Nje perdorim gjithmone e me te gjere kjo lende energjetike po gjen ne industrine ushqimore dhe ate te ndertimit.

6.2 Sektori i rafinerise

Gjate vitit 2010 shoqeria e perpunimit dhe marketingut te naftes ARMO bleu nafte brut nga Shoqeria Albpetrol 134 227 ton, nga kompania Bankers 85 300 ton, nga kompania Steam

Petroleum 37 395 ton, dhe importoi 25 208 ton dhe ne total perpunimi i naftes brut ne rafinerite tona ishte 157 470 ton,

Humbjet teknologjike te rafinerive kane qene rreth 6 %. Viti 2010 ka qene pika e ulet e shfrytezimit te naftes brut ne rafinerine e Ballshit dhe te Fierit .

Shoqeria ARMO sh.a e privatizuar ne vitin 2008 (85% e aksioneve), gjate vitit 2010 e ne vazhdim, do te mundesoje nje permiresim te ndjeshem ne sektorin e rafinimit dhe arritjen e standarteve nderkombetare ne cilesine e nenprodukteve.

Duke mbajtur ne konsiderate Totalin e Produkteve Primare Energjetike (TPPE), humbjet ne procesin e transformimit per hidrokarburet, rezultojne te jene ne nivelin e 10.6% te TPPE-se.

6.3 Cmimet e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj

Nenproduktet e naftes dhe te gazit ne tregun shqiptar jane te liberalizuara dhe ndjekin ne menyre rigoroze ecurine e cmimeve te ketyre nenprodukteve ne bursat nderkombetare duke shtuar atyre taksat dhe tatimet sipas niveleve te pershkruara, per cdo produkt, koston e transportit si dhe normen mesatare te fitimit (rreth 10%).

Per sa i perket cmimit te naftes bruto te prodhuar ne vend, pas vitit 2008, me privatizimin e shoqerise se rafinimit ARMO sh.a., ky cmim eshte i lidhur ne menyre te drejtperdrejte me kuotimin e ketij produkti ne bursen BRENT, pavaresisht nga kostoja e prodhimit te tij nga shoqerite e kerkim prodhimit qe operojne ne territorin e Republikes se Shqiperise. Mbi prodhimin e shitur te naftes bruto aplikohet nje takse prej 10%, e quajtur “Rente Minerare”, sipas dispozitave te Ligjit Nr. 9975, date 28.7.2008 “Per taksat kombetare”, i ndryshuar.

7. ENERGJIA ELEKTRIKE

Prodhimi i energjise elektrike realizohet nga shoqerija publike KESH- Gen dhe nga prodhuesit privat te cilet jane pronare te centraleve elektrike si dhe nga prodhuesit privat te cilet e kane marre me koncension nga shteti centralin elektrik, ose kane nenshkruar mareveshje koncensionare me Qeverine per ndertimin dhe shfrytezimin e centraleve te rinj.

Prodhimi publik i energjise elektrike kryhet nga Shoqeria Aksionere KESH-gen me 100% te aksioneve nga shteti si dhe nga Shoqeria “TEC-Vlora” gjithashtu me 100% te aksioneve nga shteti, e cila eshte pjese e holdingut KESH. Struktura e centraleve elektrike te prodhimit publik, ku fuqia e pergjitheshme e instaluar arrin ne 1,531 MW, nga te cilat fuqia e instaluar e HEC-ve eshte 1,433 MW dhe e TEC-eve 98 MW. Duke marre parasysh edhe fuqine e pergjitheshme te

instaluar te prodhuesve private te energjiseelektrike prej 42 MW, fuqia e pergjitheshme e instaluar ne vendin tone rezulton 1573 MW. Ne kete vleresim nuk eshte marre ne konsiderate TEC-i i Fierit, mbasi ai eshte hequr nga shfrytezimi qe ne vitin 2008, si central me rendiment shume te ulet.

Prodhimi publik i energjise elektrike ne vitin 2010 u realizua kryesisht, ose ne masen 96.3% nga centralet hidroelektrike (HEC-et) dhe vetem 3.7% nga TEC-i i Vlores. Gjate vitit 2010 prodhimi i pergjithshem i energjise elektrike nga shoqerite publike te gjenerimit ka qen 7,555.506 Milion kWh, kurse prodhimi total qe merr parasysh edhe prodhimin nga sektori privat i gjenerimit prej 159.04 Milion kWh arrin ne 7,743.295 Milion kWh (7.743 TWh) Viti 2010 nga pikpamja hidrologjike vleresohet si nje vit i jashtezakonshem, me prurje me shkalle sigurie rreth 2%, gje qe ka ndikuar pozitivisht ne prodhimin e energjise elektrike ne vend, duke arritur prodhimin rekord te te gjitha kohrave ne Shqiperi.

Ne grafikun e figures 6 eshte paraqitur prodhimi i energjise elektrike ne vendin tone gjate periudhes 1985 deri ne 2010. Sikurse vihet re nga ky grafik, prodhimi i vitit 2010 eshte prodhimi me i madh historik.

Prodhimi ditor minimal gjate vitit 2010 eshte realizuar ne daten 30 Shtator me 6.432 Milion kWh, ose 4.66 here me pak se prodhimi ditor maksimal.




Figura 6: Ecuria e prodhimit te energjise elektrike [MWh].

Ne vitin 2010, sigurimi i furnizimit me energji elektrike ka qene me i larte krahasuar me vitet e meparshme, pra jane plotesuar me shume nevojat e konsumatoreve me kete burim energjetik.

Nje dukuri e rendesishme ne punen e hidrocentraleve te sistemit, vecanerisht per vitin 2010, i cili ka qen nje vit hidrologjik i jashtezakonshem, ka qene gadishmerija shume e larte e te gjithë agregateve te centraleve. Me te drejte mund te themi se te gjithë agregatet e sistemit jane shfrytezuar sikur te ishin agregate te termocentraleve, ne saje te shkalles se larte te gadishmerise. Eshte me rendesi te theksohet se ne saje te kesaj gadishmerije eshte bere e mundur qe mos te derdhet asnje pike uji nga turbinat e centraleve pa ju marre me pare energjia.

Gjate vitit 2009 perfunduan punimet per ndertimin e TEC-it te Vlores dhe ne fund te vitit filloi testimi i tij. Gjate vitit 2010, TEC-i prodhoi 28.7 milion kWh energji elektrike dhe me pas u ndal, per shkak te nje zgjidhjeje jo shume te pershtateshme te skemes se furnizimit me uje nga deti per ftohjen e kondensatit. Ky difekt po trajtohet nga investitori per nje zgjidhje te sigurte pa shkakuar ndonje kosto shtese per KESH-sh.a.

Gjate vitit 2010 u futen ne shfrytezim 5 HEC-e te rinj (Tervoli, Hidro-Albania, Bishnica1, Dishnica dhe Lubonja) me fuqi te pergjitheshme te instaluar prej 16.1 MW dhe nje prodhim prej 41.8 Milion kWh ose sa 26.3% e prodhimit te pergjithshem te vitit 2010 nga HEC-et deri 15 MW.

Prodhimi i pergjithshem i energjise elektrike nga HEC-et deri 15 MW arriti ne 159.04 Milion kWh, nga 89.31 Milion kWh qe ishte ne vitin 2009, ose me nje rritje prej 78.1%, nga e cila 46.8 % eshte realizuar nga HEC-et e rinj te futur ne shfrytezim vetem gjate vitit 2010.

Importi i energjise elektrike.

Ne zbatim te kerkesave te Modelit Shqiptar te Tregut, importet e energjise elektrike per nevoja publike ne vendin tone, kryhen nga dy furnizues publik, ai me shumice (FPSH) ne perberje te KESH-it dhe nga OSSH (CEZ Shperndarje). Ndersa FPSH importon energji per te plotesuar nevojat e klienteve tarifore, OSSH importon energji per te mbuluar humbjet e energjise elektrike ne sektorin e shperndarjeve.

Nje vecori karakteristike e importeve te energjise elektrike gjate vitit 2010 eshte fakti se per here te pare qe mbas vitit 1998, ne bilancin e pergjithshem import-eksport, eksportet jane me te medha se importet dhe vendi yne kthehet ne vend eksportues neto i energjise elektrike. Nje dukuri e tille erdhi si rezultat i kushteve shume te mira hidrologjike dhe koeficientit te larte te gadishmerise se burimeve gjeneruese, cka beri qe nga prodhimi ne vend te mbulohet kerkesa per konsum dhe te eksportohet energji elektrike.

Ne grafikun e figures 7 eshte paraqitur bilanci import-eksport i energjise elektrike per periudhen 1985 – 2010. Sikurse vihet re deri ne vitin 1998, (me perjashtim vetem te vitit 1990) vendi yne ka qen nje vend eksportues neto i energjise elektrike.




Figura 7 Ballanca Export-Import i Energjise Elektrike (GWh)

7.1 Humbjet e energjise elektrike.

Humbjet e pergjitheshme ne shperndarje gjate vitit 2010, sipas raportimit vjetor te OSSH-se jane ne nivelin 30.38% te energjise se pergjitheshme te injektuar ne sistemin e shperndarjes, sikurse tregohet ne grafikun e figures 8, kurse niveli i arketimeve eshte raportuar me 77.2% te energjise elektrike te faturuar Koeficienti vjetor i efektivitetit per sistemin e shperndarjes (i cili merr parasysh nivelin vjetor te humbjeve dhe te arketimeve) rezulton me 53.74%. Verehet qarte se niveli i eficiences ne shperndarje eshte shume i ulet, me gjithate duhet te pranojme se ai eshte rritur me 3.74% ne krahasim me vitin 2009.




Figura 8 Ecuria e Humbjeve ne sistemin e shperndarjes

Ne sistemin e transmetimit humbjet e energjise elektrike jane ne vleften 256 GWh dhe perbejne 3% te energjise se injektuar ne sistemin e transmetimit. Humbjet totale faktike per vitin 2010, te cilat marrin parasysh humbjet ne shperndarje me 1,910 GWh dhe humbjet ne transmetim me 256 GWh jane gjithesej 2,167 GWh ose 32% e gjithe energjise se injektuar ne sistemin elektroenergjetik te vendit, ose me nje ulje me 3.3% nga viti 2009. Duhet theksuar se kjo tendence pozitive ne reduktimin e humbjeve duhet te konsolidohet dhe te vijojte ne te arthmen me ritme me te larta.

7.2 Tarifat e Energjise Elektrike

Per sektorin e energjise elektrike, cmimet e miratuara per periudhat perkatese rregullatore, perfaqesojne kostot e veprimtarise se prodhimit te sherbimeve, furnizimin me shumice, sherbimin e transmetimit, sherbimin e shperndarjes, sherbimin e furnizimit me pakice.

Duke ju referuar vendimit te ERE-s nr. 95 dt 7.12.2010, tarifa e gjenerimit prej 0.63 leke/kWh rezulton e rritur me 57.5% krahasuar me ate te vitit 2010 prej 0.4 leke/kWh. Tarifa e transmetimit i korespondonte nje tarife mesatare per sherbimin e transmetimit prej 0.73 leke/kWh. Ne perfundim te analizave dhe metodologjise se perdorur cmimi mesatar me pakice per konsumatorit tarifore rezultoi 9.53 leke/kWh qe eshte i njejte me cmimin mesatar te miratuar nga ERE per vitin 2010.




Figura 9 Cmimi mesatar i energjise elektrike

7.3. Humbjet nga Transformimi dhe Eficenca e Sistemit Energjetik Shqiptar

Ne total, humbjet nga procesi i transformimit te burimeve energjetike primare, vleresohen ne vlerat 17.61 ktoe ose 1.03% te TPP-se, dhe respektivisht humbjet ne procesin e transformimit per burimin energjetik te naftes kane qene ne vlerat 3.54 ktoe dhe per energjine elektrike 14.07 ktoe.

8. QYMYRI

Aktualisht, kapacitetet e minierave te qymyrit jane ne minimumin e tyre, duke prodhuar rreth 7000-9000 ton nga 2 milion ton qe prodhohin ne vitet '90. Ne pellgun Tirane-Durres ndodhen 70% e rezerves se pergjithshme, Korce-Pogradec 10% dhe Memaliaj 4%. Nga analizat e kryera per sa me sipër, rezulton se rezervat e provuara ne kete pellg qymyri jane rreth 114.96 Mtoe.

Karakteristikat e qymyrit ne vendin tone jane te kualitetit te dobet, ku permbajtja e sulfurit eshte rreth 3-5%, permbajtja e hirit eshte 40-60% dhe lageshtia arrin deri ne 60%. Qymyret tona kane nje fuqi kalorifike nga 2000 kcal/kg deri ne 3000 kcal/kg dhe ata nxirren nga nje thellesi deri ne 300 m, me nje gjeresi shtrese 0,7-1m.

Per shkak te kostos se larte te nxjerrjes dhe vetive fiziko-kimike jo te favorshme, qymyri vendas ne nje te ardhme te afert, nuk do te perdoret. Megjithate, duke pasur parasysh rezervat e kufizuara te hidrokarbureve ne bote, mundesia e perdorimit te qymyrit te importit per nevoja energjetike eshte lene e hapur. Natyrisht, perdorimi i tij do te behet duke respektuar rregullat strikte mjedisore per impiantet qe perdorin kete objekt energjetik.

9. DRUTE E ZJARRIT

Drute e zjarrit jane nje burim i rendesishem energjie, te cilet ka dhene dhe vazhdon te japin kontribut te ndjeshem ne bilancin energjetik shqiptar, ne plotesimin e nevojave per ngrohje, uje te ngrohte dhe gatim. Ne vitin 2010, rezulton qe 90% e druve te zjarrit jane konsumuar ne sektorin e banesave dhe vetem nje pjese e vogel ne sektorin e sherbimeve dhe te industrise. Krahasuar me periudhen e viteve te kaluara, vihet re qe struktura e konsumit te druve te zjarrit sipas sektoreve ka ruajtur te njejtin tipar, ate te perdorimit te tyre ne sektorin e banesave.


Konsumi i druve te zjarrit edhe ne vitin 2010 (e llogaritur) konsiderohet te jete ne nivelin 205 ktoe.

10. KONSUMI I BURIMEVE ENERGJETIKE NE INDUSTRIE NXJERRESE DHE PERPUNUESE TE NAFTES

Totali i vleresuar i burimeve energjetike te konsumuara ne deget e industrise nxjerrese dhe perpunuese ka qene ne vleren 29.43 ktoe, ku ne kete konsum i takon respektivisht: 29.43 ktoe ne industrine e naftes sidomos ne deget e industrise nxjerrese dhe perpunuese dhe 12 ktoe eshte konsum ne sektorin e rafinerise.

11. KONSUMI BURIMEVE ENERGJETIKE

Konsumi burimeve energjetike ne vitin 2010, ka rezultuar ne vleren e 1879.36 ktoe (shif pasqyren e bilancit bashkengjitur). Peshen kryesore ne konsumin final e ka mbajtur nafta dhe nen produktet e saj, ne nivelin e 59.5 % te totalit te konsumit te burimeve energjetike, me pas vjen energjia elektrike me 25.9% dhe 10.9% drute e zjarrit. (Grafiku 10)



Grafiku 10: Konsumi Final Energjetik sipas burimeve [ktoe]

11. KONSUMI FINAL I BURIMEVE ENERGETIKE SIPAS DEGEVE TE EKONOMISE

Konsumi final energjetik ne vitin 2010 eshte i barabarte me 1879.36 ktoe. Kontributi i sektoreve eshte perkatesisht: 26% sektori i banesave, 41% sektori i transportit, 13% industria, 9% sherbimet, 5% bujqesia.

Duke qene se burimet e energjise perdoren ne te gjithë sektoret e ndryshem te ekonomise si ne sektorin e Banesave, Sherbimeve Publike dhe Private, Industri, Transport dhe Bujqesi, lidhja midis zhvillimit ekonomik te nje vendi dhe kerkeses se tij per energji konsiderohet nje problem kyç dhe kerkon zhvillimin e nje sistemi energjetik mbeshtetes.

Siç tregohet ne kete nga figure 11, konsumatori kryesor eshte Sektori i Transportit, i ndjekur nga Sektoret e Banesave dhe Industrise. Ndersa analiza e furnizimit me burime energjetike tregon qe rol kryesor kane luajtur nenproduktet e naftes, energjia elektrike, drute e zjarrit dhe GLN.

Konsumi i Energjise ne sektorin e Banesave merr parasysh keto sherbime energjetike: ngrohje hapsirash, kondicionim ajri, uje te ngrohje sanitar, gatim, ndriçim dhe pajisje elektroshtepiake. Per rrjedhim, eshte e rendesishme te dihen se cilat do te jene mundesite per kursimin e burimeve te energjise si: energjia e elektrike, drute e zjarrit, GLN.

Sektori i Sherbimeve ka ne konsiderate kategorite e Sherbimit Publik dhe Privat, por te ndara keto ne ndertesa ekzistuese, ndertesa te reja, dhe sipas pajisjeve eficiente te energjise (keto te fundit te klasifikuara dhe te etiketuara). Sektori i Sherbimit Publik ka nje eksperience te hershme ne kerkesen per energji, bazuar kryesisht kjo ne teknologjine e vjeter, instalimet dhe organizimin e vjeter. Vetem ne disa raste njihen skemat e reja. Sistemi i te dhenave per sasine e energjise se kerkuar per çdo sherbim dhe kontributi perkates bazohet ne disa studime dhe vleresime ekspertesh, por duhet thene se mbetet problematik sigurimi i te dhenave te detajuara. Duhet theksuar, gjithashtu, se ngrohja e hapesirave, uji i ngrohje sanitar dhe ndriçimi. per te gjithë nen-sektoret ne pergjithesi eshte realizuar ne menyre te pamjaftueshme, me cilesi te ulet, per shkak edhe te mungeses se fondeve te nevojshme buxhetore per mbulimin e kerkeses per energji. (Ngrohja qendrore/lokale ne vend eshte e pazhvilluar me perjashtim te ndonje CHP (si ne qendren spitalore ne Tirane, ne Qytetin Studenti, etj).

Kontributi i Sektorit te Sherbimeve ne konsumin final te burimeve energjetike eshte respektivisht: 22.6% energji elektrike, 9.9% dru zjarri, 5.5% nenprodukte te naftes.

Sektori i Industrise, ndahet ne nensektoret e meposhtem: Metalurgji, Kimi, Materiale Ndertimi, Miniera, Ushqim/Pije/Duhan, Tekstil/Lekure/Keputje, Dru/Leter/Stampim, Mekanike dhe te tjera. Analiza e zhvillimit ekonomik per vitin 2010 tregon nje rritje te konsumit te burimeve energjetike nga 15.4% ne 16%.

Burimet energjetike ne sektorin e industrise jane energjia elektrike me 17% dhe nenproduktet e naftes me 11.9%.

Sektorin e Transportit ne Shqiperi filloi te zhvillohej me ritme te shpejta pas viteve '90, ku pervec rritjes sasiore te transportit rrugor, filloi te zhvillohej edhe infrastruktura e kapaciteteve transportuese te rrugeve, hekurudhave dhe transporti detar. Sektorin e Transportit luan nje rol te rëndësishem ne konsumin e burimeve energjetike, me 41% te konsumit Total Final (viti 2010). Rritja e numrit te mjeteve te transportit pas viteve 2000, veçanërisht ne transportin rrugor, u shoqerua me rritjen e aktivitetit te tij dhe me rritje te dukshme te konsumit te lendes djegese, te naftes dhe te benzines. Veme ne dukje se nuk ka patur ndonje zhvillim persa i perket rritjes se kontributit te transportit publik dhe kryesisht atij hekurudhor.

Shqiperia do te vazhdoje te mbetet per shume vjet nje vend ku dominon bujqesia. Peshat specifike ne GDP eshte rreth 40% e totalit te saj. Konsumi i energjise shkon ne prodhimin e te mbjellave dhe per bagetite, te cilat mbeten dhe alternativat kryesore per zhvillimin ekonomik dhe social.

Bujqesia konsumon me pak se 5 % te totalit te energjise finale. Zhvillimi i Sektorit te Bujqesise kushtezohet nga shume faktore, ku me te rëndësishmet jane:

- Ferma te vogla dhe te ndara,
- Probleme me tokat e punueshme,
- Çmime shume te larta te prodhimeve, nje prodhim i paorganizuar dhe sistem jo-efektiv i shperndarjes se prodhimit bujqesor,
- Mungesa ose pamjaftueshmeria e kreditimit bujqesor,
- Mungesa ose pamjaftueshmeria e mekanizmave bujqesore.




Figura 11: Konsumi Final i Burimeve te Energjise ne degjet e ekonomise. [ktOE]


12. ANALIZA E BURIMEVE ENERGJETIKE NE KONSUMIN FINAL SIPAS DEGEVE

12.1 Produktet e naftes

Vleresimet e bera per vitin 2010 tregojne se konsumi i produkteve hidrokarbure ka pesuar nje rritje te lehte rreth 6.2% ne vit, krahasuar me vitin 2009. Ritmi kesaj rritje ndodh si pasoje e ndikimit te i parkut te automjeteve i cili rritet me 10 % cdo vit.

Per vitin 2010, konsumi i produkteve te naftes rezulton te jete 1118.9 ktoe, ku ne kete sasi rreth 78% mbulohet nga produktet e importuara. Duke analizuar statistikat e produkteve hidrokarbure del qarte se importet jane rritur ne menyre te ndjeshme brenda 6 viteve te fundit dhe kjo parashikohet te vazhdoje edhe ne te ardhmen si pasoje e rritjes se zhvillimit ekonomik te vendit.

Duke iu referuar sektoreve ekonomik per konsumin e produkteve te naftes, transporti ze vendin kryesor me 68.2 % te totalit te konsumit final, industria me 13.9%, bujqesia me 5.6%, banesat me 7.5% sherbimet 3.1%. (figura 12).




Grafiku 12: Konsumi Final i Naftes & Nenprodukteve/ sektoreve ekonomike. Viti 2010. [%]

Krahasuar me bilancin e vitit 2010 konsumi i produkteve te naftes ne sektorin e industrise ka rritje me 9.48 ktoe si pasoje e ndikimit te rritjes se ketij sektori gjate vitit 2010. Sektori i transportit rritet me 3.63 ktoe, si pasoje e rritjes se parkut te automjeteve per vitin 2010 krahasuar me vitin 2009. Rritje te konsumit produkteve te naftes krahasuar me vitin 2009 kane patur dhe sektoret e banesave, sherbimeve perkatesisht me 11 ktoe dhe 2.5 ktoe, ndersa bujqesia ka nje rrije rreth 4 ktoe si pasoje e ndikimit te rritjes se cmimit te produkteve te naftes. (Grafiku 13)

Diezeli rezulton si karburanti kryesor ne bilancin e produkteve te naftes ne Shqiperi me rreth 60% te konsumit dhe me pas vjen benzina me 11%.

Analizat e detajuara te ecurise se konsumit te produkteve te ndryshme te naftes per vitin 2010 tregojne se gazi i lengshem i naftes eshte rritur me 17 ktoe krahasuar me vitin 2009. Kjo rritje parashikohet te vazhdoje, pasi kjo lende energjetike eshte zevendesuesja me e shpejte e energjise elektrike. Per vitin 2010 konsumi i gazit te lengshem ka qene ne nivelin 115 ktoe. (theksojme qe te dhenat mbi konsumin e produkteve te naftes jane bazuar mbi te dhena zyrtare dhe vleresime nga AKBN-ja).



Grafiku 13: Konsumi Final i Energjise produkteve te naftes ne deget e ekonomise 1999-2010 [ktoe]

12.2 Konsumi i Energjise Elektrike sipas degeve te ekonomise

Rritja mesatare vjetore e kerkeses per energji gjate kesaj periudhe rezulton ne vlefte absolute me 161.5 GWh/Vit. Ne periudhen perpara vitit 2008, per shkak te nderprerjeve te programuara te energjise ky tregues nuk eshte real. Duke ju referuar viteve 2008, 2009 dhe 2010 rritja e kerkeses per energji ne vitin 2009 rezulton ne vlefte absolute me 292GWh me shume ndaj vitit 2008, ose me 4.6% me shume, ndersa ne vitin 2010 me 181GWh ose me 2.74% me shume se viti 2009.

Ne bilancin e pergjithshem energjetik per vitin 2010, merren ne konsiderate pervec prodhimit edhe importet, shkembimet, konsumi dhe humbjet e energjise elektrike ne sistemin elektroenergjetik,

Ne vitin 2010, sikurse verehet nga grafiku dhe tabela perkatese eshte arritur konsumi me i madh historik ne vendin tone me 6.773 TWh. Tendence e pergjitheshme e konsumit te energjise elektrike eshte rritja vjetore e kerkeses per energji elektrike mesatarisht me rreth 3%. Krahas

ritjes se kerkeses per energji elektrike eshte rritur edhe piku i ngarkeses nga 420 MW ne vitin 1985 ne 1402 MW ne vitin 2010 me nje rritje mesatare vjetore prej 37.3MW.




Figura 14 Konsumi i pergjithshem ne vite energjise elektrike

Struktura e konsumit te energjise elektrike shpreh ne menyre te sintetizuar edhe shkallen e zhvillimit ekonomiko-industrial te nje vendi. Ne vendin tone konsumi familjar ndaj konsumit te pergjithshem te faturuar edhe per vitin 2010 perben 54.9% cka tregon nje ekonomi me zhvillim industrial te kufizuar. Duke qene keshtu, ritmet e larta te zhvillimit ekonomik te vendit do te ndikojne edhe ne rritjen e ritmeve te kerkese per energji.

Konsumi familjar ndaj konsumit te pergjithshem te faturuar perben 48.5%, cka tregon nje ekonomi me zhvillim industrial te kufizuar. Duke qene keshtu, ritmet e larta te zhvillimit ekonomik te vendit do te ndikojne edhe ne rritjen e ritmeve te kerkeses per energji. (Figura 15)

Sic vihet re nga grafiku, peshen me te madhe ne konsumin e energjise elektrike per vitin 2010, e mban sektori banesave me 45.7%, e me pas vijne sherbimet me 21.1%, industria 18.3%, te tjera 13.1% dhe bujqesia me 1.8%.

Ne sektorin shtepiak eshte ruajtur e njejta strukure e konsumit te energjise elektrike, respektivisht; 28% e energjise elektrike te konsumuar eshte perdorur per ngrohje, rreth 21%, konsumohet per uje te ngrohje, rreth 25% per gatim etj.




Figura 15: Konsumi final i energjise elektrike ne deget e ekonomise. Viti 2010 [%]

Ne degen e industrise peshen me te madhe ne konsumin e energjise elektrike e mban Industria Ushqimore e Pijeve & Duhanit me 20%, me pas vijne deget e industrise materialeve te ndertimit me 18%, e hekurit me 15%, etj.

Ne Sektorin e Sherbimeve vihet re e njejta strukture e konsumit te energjise elektrike, konkretisht: per gatim, kondicionim (ngrohje dhe freskim), ndricim, paisjet elektroshtepiake, etj. Sektori i Sherbimeve ze rreth 10% te totalit te konsumit final te burimeve energjetike dhe ne menyre specifike 23.6% te konsumit te energjise elektrike.

13. DRUTE E ZJARRIT DHE QYMYRI

Drute e zjarrit dhe qymyri nuk paraqesin ndryshime strukture te perdorimit te tyre ne deget e ekonomise, megjithate veme ne dukje qe mungojne informacionet e sakta per furnizimin dhe konsumin me keto burime energjie.

14. KONSUMI I BURIMEVE TE RINOVUESHME

HEC-et e vegjel

Aktualisht jane ne prodhim 51 hidrocentrale nga 19 shoqeri private dhe koncensionare, me fuqi te pergjitheshme te instaluar prej 25,874 kW dhe me nje prodhimtari te pergjitheshme per vitin 2010 prej 159.04 milion kWh ose 2.0 % e prodhimit te pergjithshem te vitit 2010. Ne tabelen 2.4. eshte paraqitur prodhimi mujor i energjise elektrike gjate vitit 2010 nga 19 shoqerite koncensionare dhe private qe kane ne administrim ose pronesi 51 hidrocentrale me fuqi deri 15 MW. Prodhimi vjetor i energjise elektrike nga seicili prej 51 HEC-eve me fuqi deri 15 MW. Gjate vitit 2010 u futen ne shfrytezim 5 HEC-e te rinj (Tervoli, Hidro-Albania, Bishnica1,

Dishnica dhe Lubonja) me fuqi te pergjitheshme te instaluar prej 16.1 MW dhe nje prodhim prej 41.8 Milion kWh ose sa 26.3% e prodhimit te pergjithshem te vitit 2010 nga HEC-et deri 15 MW. Prodhimi i pergjithshem i energjise elektrike nga HEC-et deri 15 MW arriti ne 159.04 Milion kWh, nga 89.31 Milion kWh qe ishte ne vitin 2009, ose me nje rritje prej 78.1%, nga e cila 46.8 % eshte realizuar nga HEC-et e rinj te futur ne shfrytezim vetem gjate vitit 2010.

Energjia Diellore

Territori i Shqiperise eshte i vendosur ne pjesen perendimore te Ballkanit dhe ka nje potencial te larte per shfrytezimin e energjise diellore. Numri i diteve me diell ne vendin tone luhetet nga 240–260 dite me nje maksimum prej 280 dite, megjithate kontributi i kesaj energjie perkundrejt totalit te burimeve energjetike eshte jo me shume se 0.1%. Kryesisht energjia diellore shfrytezohe per prodhimin e ujit te ngrohje sanitar dhe nje pjese fare e vogel e kesaj energjie shfrytezohe me panele fotovoltaike.

Energjia e eres

Shfrytezimi i energjise se eres ne vendin tone akoma nuk ka filluar, por ka nje interesim shume te madhe nga investitore te huaj per shfrytezimin e ketij burimi. Ne kete kuader jane ne studim disa rajone te vendit tone nga disa kompani te huaja. Deri ne fund te vitit 2008 nga ERE jane licensuar shtate kompani per te ndertuar parqe eolike te cilat shtrihen kryesisht ne zonen bregdetare te vendit, duke filluar nga qarku i Lezhes ne veri e deri ne rajonin e Sarandes ne jug.

Biomasa

Biomasa ne vendin tone vleresohet si burim energjie dhe eshte ngushtesisht e lidhur me drute e zjarrit. Ne vitin 2008, rezulton qe 93% e druve te zjarrit jane konsumuar per ngrohje dhe gatim dhe vetem 7% jane perdorur ne sherbime te tjera. Biomasa kontribuon nepermjet druve te zjarrit ne bilancin energjetik te vendit me 10%. Ne mbeshetje te shrytezimit te biomases ne vitin 2008 i eshte dhene licensa per ndertim, instalim dhe prodhim, te nje TEC-i me kapacitet 140 MW i cili do te kete si lende djegese vajra te ndyshem organik.

	Year 2010	TOTAL	Solid fuels	Natural Gas	Crude, NGL and Feedstock	Biomass (Fuelwood)	Hydro & Electricity	Solar Energy	Derived Heat
Primary production		1643.22	3.2	12.8	743.945	205	665.92	6.70	5.6
Recovered products		0.00			0.0				
Imports (Pet Prod+ Electricity)		1306.15	55.0		1080.43		170.73		
Stock change		89.97			89.97				
Exports		753.84			501.50		252.34		
Bunkers		0.00							
Gross inland consumption		2105.55	58.19	12.8	1232.90	205.00	584.31	6.70	5.60
Transformation input		823.32			157.47		665.85		
Classic thermal Power Stations		5.00			5				
Public Hydro power stations		665.85					665.85		
Autoprod. thermal power stations		0.00			0.00				
Nuclear power stations		0.00							
Patent fuel and briquetting plants		0.00							
Coke-oven plants		0.00							
Blast-furnace plants		0.00							
Gas works		0.00							
Refineries		157.47			157.471				
District heating plants		0.00							
Transformation output		663.20	0	0	153.93		651.78		3.3
Classic thermal Power Stations		0.07					0.07		
Public Hydro power stations		651.70					651.70		
Autoprod. thermal power stations		0.00							
Nuclear power stations		0.00							
Patent fuel and briquetting plants		0.00							
Coke-oven plants		0.00							
Blast-furnace plants		0.00							
Gas works		0.00							
Refineries		157.23			153.93				3.3
District heating plants		0.00	0						
Exchanges and transfers, returns		0.00							
Interproduct transfers		0.00							
Products transferred		0.00							
Returns from petrochem. industry		0.00							
Transformation Losses		17.61	0	0	3.54		14.07		
Consumption of the energy branch		29.43		12.0	17.00		0.43		0
Production and distribution of electricity		0.41					0.41		
Pumped storage stations		0.00							
District heating plants		0.00							
Extraction and aggl. of solid fuels		0.00							
Coke-oven and gas works plants		0.00							
Oil and Nat. Gas extraction plants		17.01		5.0	12.00		0.01		
Oil & Gas pipelines		0.00							
Oil refineries		12.01		7.0	5		0.01		
Nuclear fuel fabrication plants		0.00							
Distribution losses (humbje jo tekn ne shpernd)		82.36					82.36		0.00
Available for final consumption		1967.84	58.19	0.8	1207.36	205.00	487.44	6.70	2.30
Final non-energy consumption		88.48			88.48				
Chemical industry		12.90			12.90				
Other sectors		75.58			75.58				
Final energy consumption		1879.36	58.2	0.8	1118.9	205.0	487.44	6.7	2.3
Industry		306.57	55.0		157.28	3	89.00		2.3
Iron & steel industry		26.71			14.97		11.74		
Non-ferrous metal industry		4.39			0.05		4.35		
Chemical industry		16.98			9.90		7.08		
Glass, pottery & building mat. industry		157.22	54.99		88.35		13.88		
Ore-extraction industry		5.47			0.49		4.99		
Food, drink & tobacco industry		37.50			17.79		17.42		2.3
Textile, leather & clothing industry		12.31			0.93		11.38		
Paper and printing		8.14			1.00		7.14		
Engineering & other metal industry		7.73			3.50		4.23		
Other industries		31.20		0.80	20.30	3	7.10		
Transport		759.44			759.44				
Railways		3.00			3.00				
Road transport		728.48			728.48				
Air transport		21.50			21.50				
Inland navigation		6.46			6.46				
Households, commerce, pub. auth., etc.		649.34	3.2		119.00	195.0	325.44	6.70	
Households		489.42	0.9		84.00	180	222.52	2.00	
Agriculture		79.00			63.00	7	9.00		
Fisheries		20.00			20.00				
Other		64.00			0.00		64.00		
Statistical difference					170.00			0	0